



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.327/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizmi me seli në Komuna Prishtinë, të parashtruar kundër Subjektit Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

- I. **PRANOHET E BAZUAR** ankesa e OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizmi me seli në Komuna Prishtinë, Anr.327/2025 datë 03.02.2025.
- II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00, Euro (pesëmijëepesqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP ka pranuar një ankesë nga OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datë 01 shkurt 2025, ora 19:19, gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni për Familje në qytetin e Rahovecit, ngjarje e cila më pas është postuar në rrjetin social Facebook, janë bërë deklaratat të cilat përmbajnë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standardet ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Deklaratat janë bërë nga kandidati për deputet i këtij subjekti, z. Eman Rrahmani dhe z.Fatmir Smajli dhe përfshijnë elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejtë ndaj një komuniteti të caktuar.

Deklarata e evidentuar: Në minutazhin 32:27-32:58, z.Fatmir Smajli ka deklaruar "*Na shqetësoi shumë fakti për çka edhe nga kush po nxiten edhe po yshten këta njerëz mi ba këto dame për familjet tona. Edhe n'shqetësim e sipër e kujtova mirë çka janë tu dashtë me shkatrru: familjen!*" Ky formulim përmban gjuhë që synon të portretizojë individët dhe

organizatat LGBTI+ si armiq të “familjes” dhe si shkaktarë të dështimeve të saj. Duke mos përshkruar ndonjë akt konkret, por vetëm duke aluduar që “dikush” po synon shkatërrimin e familjes, krijohet një një ndjenjë e frikës dhe urrejtje ndaj grupeve të caktuara shoqërore. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se, më tej në minuten 59:28-01:02:55, z.Eman Rrahmani ka deklaruar *“N’këtë ligj ata propozun që me pasë mundësi me ndërru gjininë njeri çdo 10 vjet. Çohesh n’mëngjes, shkon n’Komunë i thu prej sot s’jom mo burrë, po du mu regjistru si gru. More ti koke...”* Sipas parashtruesit të ankesës, përveç që ky përshkrim përmban shtrembërimin të ligjit për gjendjen civile, ai gjithashtu përmban përshkrime tallëse dhe nën përçmuese të personave transgjnorë, duke krijuar një narrativë denigruese dhe duke nxitur stigmatizim public ndaj kësaj kategorie shoqërore. Në minutazhin 01:03:35-01:04:40, z.Rrahmani vijon me një ndarje të thellë mes grupeve shoqërore duke përdorur termin *“flamurin lara-lara”*, si mjet për të diskredituar dhe përjashtuar personat që nuk ndajnë të njëjtin vision dhe ai krijon një kundërvendosje të rrezikshme duke i ndarë qytetarët në ata që *“mbrojnë familjen”* dhe ata që *“janë kundër saj”*. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se në minuten 01:05:10-01:05:40, ai vazhdon *“Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër vlerave të familjes! Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër të ardhmes së vendit, është marre dhe turp për secilin që angazhohet kundër qytetarëve të vendit, të shtetit dhe të vendit tij.”* Sipas parashtruesit të ankesës, ky formulim sugjeron se kushdo që angazhohet në mënyrë aktive për të drejtat e komunitetit LGBTI+ dhe barazinë gjinore është kundër familjes, kundër vendit dhe qytetarëve, kjo paraqet nxitje të qartë të urrejtjes ndaj organizatave që mbrojnë të drejtat e njeriut si dhe shtyn në përçarje të ashpër të shoqërisë kosovare duke synuar ta ndajë atë në dysh. Në ankesë është theksuar se këto deklarata përbëjnë shkelje të dispozitave Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Kodit të Mirësjelljes dhe nenit 34 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes ankesës, parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP që të konstatojë shkeljen e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe kandidatët Eman Rrahmani, dhe Fatmir Smajli, të ndërmarrë masa ndëshkuese ndaj Koalicionit për Familje dhe kandidatëve për përdorimin e gjuhës nxitëse dhe diskriminuese dhe të kërkojë publikisht nga Koalicioni për Familje që t’i tërheqë deklaratat diskriminuese dhe të kërkojnë falje publike ndaj komunitetit LGBTI+, si dhe t’i shqiptojë gjobë ndaj subjektit politik për shkeljet e lartëpërmendura.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun:

<https://www.facebook.com/koalicioniperfamiljen/videos/498351873302808>

PZAP me datë 04.02.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 04.02.2025, në ora 18:30 e as më vonë.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, vëren se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të shkresave të ofruara si provë materiale në ankesë, të cilat janë bërë nga Koalicioni për Familjen, respektivisht nga kandidati për deputet Fatmir Smajli i cili gjatë fushatës ka deklaruar duke përdorur fjalët *“Na shqetësoi shumë fakti për çka edhe nga kush po nxiten edhe po yshten këta njerëz mi ba këto dame për familjet tona. Edhe n’shqetësim e*

sipër e kujtova mirë çka janë tu dashtë me shkatrru: familjen!” si dhe kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen Eman Rrahmani i cili ka deklaruar duke përdorur fjalët “N’këtë ligj ata propozun që me pasë mundësi me ndërru gjininë njeri çdo 10 vjet. Çohesh n’mëngjes, shkon n’Komunë i thu prej sot s’jom mo burrë, po du mu regjistru si gru. More ti koke...”, “flamurin lara-lara”, “Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër vlerave të familjes! Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër të ardhmes së vendit, është marre dhe turp për secilin që angazhohet kundër qytetarëve të vendit, të shtetit dhe të vendit tij.”, të cilat deklarata janë publikuar, me video në rrjetin social facebook në faqen e subjektit Koalicioni për Familje, gjen se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet, “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”, andaj për Panelin një veprim i tillë i subjektit politik në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj, Paneli gjeti se gjuha e përdorur nga subjekti politik Koalicioni për Familjen, përkatësisht, nga kandidatët e këtij subjekti Fatmir Smajli dhe Eman Rrahmani, ndaj LGBTI+, në fushatë zgjedhore dhe postimi i postuar në rrjetin social Facebook nga subjekti Koalicioni për Familje është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike. Në këtë rast është marrë për bazë konteksti dhe qëllimi për të cilin është përdorur gjuha ndaj një komuniteti, faktin që deklaratat janë publikuar në rrjetin social Facebook, prandaj sipas Panelit, përdorimi i gjuhës së tillë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrime përçmuese ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse. Përdorimi i kësaj gjuhe nga kandidatët për deputet sipas Panelit është shkelur etika zgjedhore dhe standardet e sjelljes në fushatë zgjedhore. Sjellja e tillë minon procesin demokratik dhe promovimin e zgjedhjeve të lira e të drejta. PZAP, me rastin e shqiptimit të gjobës ka marrë për bazë kontekstin se deklarata është bërë në kohën e fushatës zgjedhore dhe se fjalitë e përdora i referohen grupeve të caktuara dhe si të tilla përmbajnë elemente të nxitjes së urrejtjes, diskriminimi dhe cenim të drejtave të grupeve që u është referuar.

Fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen në një ambient të ndershëm dhe të drejtë, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve dhe grupeve shoqërore. Shprehjet që përdorin fjalë si “turp” dhe “marre”, “flamurin lara-lara” për të sulmuar individë, grupe apo organizata të caktuara mund të krijojnë një atmosferë të pasigurt dhe të ndarë, duke shkelur kështu parimet e një fushate pozitive dhe të respektueshme.

Njëherit paneli i PZAP-it, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të këtij vendimi morri për bazë edhe vendimin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut Sanchez kundër Francës [DHM], kërkesa nr. 45581/15, Vendimi gjyqësor i datës 15 maj 2023, në të cilin vendim ndër të tjera thuhet se : *“Megjithatë, liria e debatit politik mund të kufizohet për të penalizuar apo edhe për të parandaluar të gjitha format e shprehjes që propagandojnë, inkurajojnë, nxisin ose justifikojnë urrejtjen bazuar në intolerance...”*.

Në nenin 10 par.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndër të tjera thuhet se *“Çdo person ka të drejtën e lirisë së shprehjes...”*, ndërsa në paragrafin 2 të nenit 10 të Konventës ndër të tjera thuhet se *“Ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji që, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masat e nevojshme ... për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve...”*.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes.

Në lartësinë e gjobës paneli ka marrë për bazë faktin se subjekti politik në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.


Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.327/2025 datë 06.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.45/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Delushe Halimi dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike lidhur me ankesën Subjektit Politik, Koalicioni Për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025, në seancën e mbajtur me datë 14.02.2025, merr këtë:


A K T V E N D I M

Hedhet si e pasafatshme ankesa e subjektit politik, Koalicioni Për Familje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025, është vendosur: I. Pranohet e bazuar Ankesa e OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizmi me seli në Komuna Prishtinë, Anr.327/2025 datë 03.02.2025. II. Subjektit politik Koalicioni për Familje me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5,500.00, Euro (pesëmijëepesqind) Euro. III. Detyrohet Subjekti Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik, Koalicioni për Familje, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 të LZP-së, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNJ-në, me pretendim se në deklaratimet e kandidatëve Fatmir Smajli dhe Eman Rrahmani, askund nuk bëhet thirrje për dhunë apo urrejtje dhe se asnjë ligj Zgjedhor në Kosovë nuk ndalon kandidatët të shprehin mendime të tilla, përderisa ato nuk përbëjnë thirrje të qarta për dhunë.



ose urrejtje dhe se liria e shprehjes është e garantuar, duke propozuar që Gjykata Supreme ankesën ta aprovojë, të anulojë gjobën e vendosur ndaj Koalicionit Për Familje, duke njohur deklaratat e Koalicionit si shprehje e mbrojtur politike sipas nenit 10 të KEDNJ-së, ashtu që të rikonfirmohet rëndësia e lirisë së shprehjes në nxitjen e debatit demokratik.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit politik, Koalicionit Për Familje me seli në Prishtinë, kundër vendimit të lartpërmendur të ankimuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe propozon që ankesa e subjektit politik të dënuar me këtë vendim të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr.327/2025, i datës 06.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pasaftshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 03.02.2025, PZAP ka pranuar një ankesë nga OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizëm, me seli në Prishtinë, të parashtruar, kundër subjektit politik Koalicionit Për Familje, me seli në Prishtinë.

Në ankesën Anr.327/2025, të datës 03.02.2025, OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizm me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër subjektit politik Koalicioni Për Familje, pretendon se me datë 01 shkurt 2025, ora 19:19, gjatë fushatës zgjedhore të subjektit politik Koalicioni Për Familje në qytetin e Rahovecit, ngjarje e cila më pas është postuar në rrjetin social Facebook, janë bërë deklaratat të cilat përmbajnë gjuhë nxitëse dhe stigmatizuese ndaj komunitetit LGBTI+, duke shkelur standardet ligjore dhe etike të përcaktuara nga Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët. Deklaratat janë bërë nga kandidati për deputet i këtij subjekti, z. Eman Rrahmani dhe z.Fatmir Smajli dhe përfshijnë elemente që nxisin urrejtje dhe stigmatizim të drejtpërdrejtë ndaj një komuniteti të caktuar. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur linkun: <https://www.facebook.com/koalicioniperfamiljen/videos/498351873302808>.

OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizëm, me seli në Prishtinë, në ankesën e paraqitur, pretendon se kandidati për deputet Fatmir Smajli, gjatë fushatës ka deklaruar duke përdorur fjalët: *"Na shqetësoi shumë fakti për çka edhe nga kush po nxiten edhe po yshten këta njerëz mi ba këto dame për familjet tona. Edhe n'shqetësim e sipër e kujtova mirë çka janë tu dashtë me shkatrru familjen!", si dhe kandidati tjetër i Koalicionit për Familjen Eman Rrahmani, i cili ka deklaruar duke përdorur fjalët: "N'këtë ligj ata propozun që me pasë mundësi me ndërru gjininë njeri çdo 10 vjet. Çohesh n'mëngjes, shkon n'Komunë i thu prej sot s'jom mo burrë, po du mu regjistru si gru. More ti koke...", "flamurin lara-lara", "Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër vlerave të familjes! Është marre, është turp për secilin që angazhohet kundër të ardhmes së vendit, është marre dhe turp për secilin që angazhohet kundër qytetarëve të vendit, të shtetit dhe të vendit tij.", të cilat deklaratat janë publikuar, me video në rrjetin social facebook në faqen e subjektit Koalicioni Për Familje, dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.11, të LZP-së.*



PZAP me datë 04.02.2025, i është drejtuar me kërkesë për përgjigje subjektit politik Koalicionit Për Familje, mirëpo ky subjekt politik nuk është përgjigjur në afatin e paraparë deri më datë 04.02.2025, në ora 18:30 e as më vonë.

Pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, PZAP-i, ka nxjerr vendimin A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025, me të cilën e ka aprovuar ankesën e OJQ Qendra për Barazi dhe Liri (CEL Kosova) dhe Dylberizm, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

Kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025, subjektit politik, Koalicioni Për Familje, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila në këtë çështje juridike fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e pasafatshme, për arsye se:

Me neni 118, paragrafi 4, të Ligji nr. 08/l-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja, mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.”*

Duke u bazuar në dispozitën ligjore të cituar më lartë, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ankesa e parashtruar, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.327/2025, të datës 06.02.2025, nuk lejohet, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesës, të kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e ankesës i cili është dyzet e tetë (48) orë nga pranimi i vendimit të PZAP-së.

Si rrjedhojë, nga shkresat e lëndës konstatohet se vendimin e ankimuar, subjekti politik Koalicioni Për Familje, e ka pranuar më datën 07.02.2025 në orën 12:35h, ndërsa ankesën kundër këtij vendimit, ky subjekt politik e ka dorëzuar në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes postës më datë 10.02.2025, (që vërtetohet nga vula e postës në zarf), e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit prej dyzet e tetë (48) orëve. Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës fillon të llogaritet nga data 07.02.2025 ora 12:35h, ndërsa koha e fundit e afatit për paraqitjen e ankesës ka qenë 09.02.2025, ora 12:35h, për çka edhe ankesa është e palejuar, për shkak se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor prej dyzet e tetë (48) orëve.

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 118.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.45/2025, datë 14.02.2025



Republika e Kosovës
Kryetari i Kolegjit,
Lunni Sallauka
SAKTËSINË E KOPJËS E TËRËT
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE
Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUДСКИ САВЕТ КОСОВО/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisi:

AA-45/2005

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjjet në vendin e ku është dashur të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lamërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stani radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas,
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënskrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bëri vizë - nepotrebne precrati)

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTUENDIM 14.02.2005

Numri i shtojcave: _____

broj priloga _____

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë) _____

Povrditjemo prijem gorenavenog pisma (i slovima) _____

_____ 14.02.2005

(Nënskrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primaoca ili lica koje je pismeno primilo u zvanem)

Nënskrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënskruajë dorëzuesit, duke shkruar shkruar pse marrësi nuk e ka vendë nënskrimin e tij. Ako je primilac neplešan ili nije u stanju da se potpisuje, potpisuje ga dostavljač. Napomena: zasto primilac nije stavio svoj potpis.